

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **651-26-5408-2-2-5**

Sa i përket tenderit për **Dezinsektimi i hapsirave publike**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	MONUNI SH.P.K
NUI	811431238
Adresa	Rr. Washingtonit nr.65
Vendi	GJILAN
Kodi postar	60000
Numri Telefonit	043/555/655
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Uron Maloku
Adresa elektronike	procurement@monuni.com
Data e parashtrimit të ankesës	05.08.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Dezinsektimi i hapsirave publike

Autoriteti Kontraktues ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit nr. 651-26-5408-2-2-5, me titull “Dezinsektimi i hapësirave publike”, përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Vlera e parashikuar ishte 75,000.00 euro, kohëzgjatja e deklaruar 45 ditë ose dy muaj, ndërsa objekti përfshinte dezinfektimin hapësinor të 3,900 hektarëve në territorin e Komunës së Gjilanit me aplikim ULV dhe preparate kimike të përcaktuara në specifikimet teknike.

Afati për dorëzimin dhe hapjen e tenderëve ishte 20.07.2026, ora 14:00. Në procesverbal figurojnë katër oferta: Jusuf Berisha – 76,440.00 euro; Offishop Group SH.P.K. – 78,000.00 euro; Vector Pest Control SH.P.K. – 74,880.00 euro; dhe Green Belt SH.P.K. – 77,220.00 euro. Për kontratë është rekomanduar Vector Pest Control SH.P.K. me çmim 74,880.00 euro.

B58 mban datën 23.07.2026, mirëpo për MONUNI SH.P.K., e cila nuk ishte e ftuar, aktiviteti dhe dokumentacioni u bënë publikisht të qasshëm për herë të parë me publikimin e B08 më 30.07.2026. Po atë ditë, MONUNI SH.P.K. paraqiti Kërkesë për Rishqyrtim përmes platformës elektronike.

B52, i përgatitur më 04.08.2026 dhe i publikuar më 05.08.2026, deklaroi se aktiviteti është iniciuar më 03.07.2026, kontrata është nënshkruar më 29.07.2026 dhe se fitues është Vector Pest Control SH.P.K. me vlerë 74,880.00 euro. Sipas publikimeve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, procesi i dezinfektimit hapësinor ishte caktuar të fillonte më 01.08.2026, ora 19:30, dhe ka filluar në atë datë.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

MONUNI SH.P.K. paraqiti Kërkesë për Rishqyrtim përmes platformës elektronike më 30.07.2026, data kur u bë projekti publikisht i qasshëm për herë të parë me publikimin e B08. AK nuk e ka shqyrtuar kërkesën e MONUNI SH.P.K.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik:

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 – Barazia në Trajtim, Mosdiskriminimi dhe Transparenca;
Neni 27 – Dosja e Tenderit;
Neni 35, paragrafi 1;
Neni 35, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 (iii);
Neni 35, paragrafi 3;
Neni 41/A – Njoftimi për nënshkrimin e kontratës;
Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, versioni i konsoliduar me Rregulloren Nr. 002/2024:

Neni 4.1 dhe neni 4.3, veçanërisht pikat a), c), e) dhe f);
Neni 17.12 dhe neni 17.17, pikat a) dhe b);
Neni 21.8, pikat a) dhe c);
Neni 44.2 – Përdorimi dhe përmbajtja e formularëve standardë;
Neni 45.35.3 – Përgatitja e B52 brenda dy ditëve nga nënshkrimi;
Neni 48.2, neni 48.3 pikat a), b), c), d), dhe neni 48.4 pikat a), b), c);
Neni 50.4, neni 50.5 dhe neni 50.6 – njoftimi i KRPP-së dhe përzgjedhja e operatorëve të përshtatshëm;
Neni 61.3 dhe neni 63.2 – publikimi, shqyrtimi dhe vendosja e kërkesës për rishqyrtim.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

I. Interesi juridik dhe e drejta e MONUNI SH.P.K. për ankesë

MONUNI SH.P.K. është palë e interesuar sepse ushtron profesionalisht veprimtarinë DDD, posedon leje valide të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me referencë 04.5-205/26, të vlefshme nga 22.06.2026 deri më 22.12.2026, dhe do të kishte paraqitur ofertë nëse do të ishte ftuar.

MONUNI ka realizuar së paku njëmbëdhjetë kontrata në shërbimin e fushës së Dezinsektimit me vetë Komunën e Gjilanit gjatë periudhës 2009–2025. Ndër to përfshihen kontratat për dezinfektim hapësinor në Komunën e Gjilanit në vitet 2014, 2018, 2019 dhe 2022, si dhe kontrata me Spitalin e Përgjithshëm Gjilan. Për rrjedhojë, AK kishte njohuri të drejtpërdrejtë për përvojën, kapacitetin dhe profilin profesional të ankuesit.

Në procedurën e negociuar pa publikim, B08 është njoftimi i parë që bëhet publikisht i qasshëm për palët e paftuara. MONUNI nuk mund të paraqiste mjet juridik për një aktivitet të cilit nuk e njihte dhe në të cilin nuk kishte qasje. Kërkesa e datës 30.07.2026 është paraqitur në ditën e parë të dijenisë dhe është e afatshme.

II. Mosnxjerrja e vendimit mbi Kërkesën për Rishqyrtim

MONUNI SH.P.K. e ka paraqitur Kërkesën për Rishqyrtim më **30.07.2026**, menjëherë pasi aktiviteti është bërë për herë të parë publikisht i qasshëm. Kërkesa është paraqitur brenda afatit dhe është dashur të shqyrtohej e të vendosej nga Autoriteti Kontraktues.

Fakti që B52 më vonë tregon se kontrata ishte nënshkruar më **29.07.2026**, pra para publikimit të aktivitetit dhe para se MONUNI SH.P.K. të kishte mundësi të merrte dijeni për procedurën, nuk e bën kërkesën të vonuar dhe as të pavlefshme. Përkundrazi, afati për

MONUNI SH.P.K. ka filluar vetëm nga momenti kur aktiviteti është bërë publikisht i qasshëm më 30.07.2026.

Pavarësisht kësaj, AK nuk ka nxjerrë vendim mbi kërkesën, nuk ka trajtuar pretendimet e ngritura dhe nuk ka njoftuar për zgjatje të afatit. Ky mosveprim përbën shkelje të detyrimit për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesës për rishqyrtim dhe ka cenuar të drejtën e ankuesit për mjet juridik efektiv.

II. Mungesa e kushteve kumulative për emergjencë ekstreme

Procedura e negociuar pa publikim është përjashtim nga rregulli i konkurrencës së hapur dhe lejohet vetëm kur plotësohen në mënyrë kumulative: domosdoshmëria strikte, ekzistimi i një ngjarjeje objektivisht të verifikueshme dhe të paparashikueshme, pamundësia për të respektuar edhe afatet e përshpejtuara, dhe kushti që urgjenca të mos i atribuohet veprimeve, mosveprimeve ose neglizhencës së AK-së.

Dokumentet e vetë AK-së tregojnë se procedura e hapur paraprake ishte zhvilluar me afate të shkurtuara për shkak të vonesave në miratimin e buxhetit dhe nevojës për harmonizim e koordinim ndërmjet drejtorive. Këto janë rrethana administrative të brendshme dhe jo ngjarje të jashtme, të reja dhe të paparashikueshme.

Dezinsektimi veror është nevojë sezonale dhe periodike. AK kishte publikuar procedurën e hapur më 11.06.2026 dhe kishte dijeni paraprake për objektin, sasinë, sezonin dhe nevojën. Ankesa dhe pezullimi i aktivitetit të hapur janë mekanizma të parashikuar nga LPP-ja dhe nuk mund të shndërrohen automatikisht në “ngjarje të paparashikueshme”.

Vetë dosja e negociuar e lidh kontratën e përkohshme me faktin se procedura e hapur ishte në fazën e ankesës në OSHP dhe parashihte ndërprerjen e saj kur procedura e hapur të vazhdonte. Kjo tregon se arsyeja e procedurës së negociuar ishte menaxhimi i pasojave të pezullimit të procedurës së hapur, dhe jo ndonjë ngjarje e re epidemiologjike e dokumentuar në materialet publike.

B52 shënon iniciimin e aktivitetit më 03.07.2026 dhe nënshkrimin e kontratës më 29.07.2026, pra një periudhë prej rreth 26 ditësh. Kjo kohëzgjatje e bën të domosdoshme që AK të arsyetojë konkretisht pse nuk mund të realizonte një procedurë tjetër me afate të përshpejtuara. Vetëm përdorimi i termit “emergjencë” nuk e zëvendëson provën e pamundësisë faktike për respektimin e afateve alternative.

Po ashtu, procedura e negociuar ka përfshirë të gjithë komponentin prej 3,900 hektarësh, identik me sasinë e dezinfektimit në procedurën e hapur. AK nuk ka dhënë arsyetim publik pse e gjithë kjo sasi dhe vlera 75,000.00 euro ishin “strikt të domosdoshme”, në vend të një mase të kufizuar, të përkohshme dhe vetëm për zonat ku eventualisht do të provohej rreziku urgjent.

IV. Përzgjedhja e operatorëve të ftuar pa kriteret objektive dhe mosftimi diskriminues i MONUNI SH.P.K

Neni 50.6 i Rregullores kërkon që pjesëmarrësit në procedurën e negociuar pa publikim të përzgjidhen ndërmjet operatorëve ekonomikë të përshtatshëm dhe pa synim diskriminues në dëm ose në favor të ndonjë operatori.

AK nuk ka paraqitur metodologji objektive, kriteret të hulumtimit të tregut ose arsye të përshtatshme për të ftuar pikërisht Jusuf Berisha, Offishop Group SH.P.K., Vector Pest Control SH.P.K. dhe Green Belt SH.P.K., ndërsa nuk është ftuar MONUNI SH.P.K. Mosftimi i MONUNI SH.P.K. është veçanërisht i pajustificueshëm, pasi ky operator është i licencuar, ka përvojë shumëvjeçare në fushën DDD dhe ka realizuar për vetë Komunën e Gjilanit katër kontratat e fundit për shërbime DDD dhe dezinfektim hapësinor në këtë komunë, përkatësisht: kontratën nr. 16/79934, datë 14.07.2022, në vlerë 101,690.00 euro; kontratën nr. 16/55908, datë 20.05.2019, në vlerë 135,994.00 euro; kontratën nr. 16-59843, datë 18.06.2018, në vlerë 103,599.60 euro; kontratën nr. 16-111506, datë 24.09.2014, në vlerë 160,350.00 euro. Përmes këtyre kontratave, AK ka pasur njohuri të drejtpërdrejta për licencimin, përvojën, kapacitetin profesional dhe aftësinë operative të MONUNI SH.P.K. për realizimin e dezinfektimit hapësinor në territorin e Gjilanit. Për këtë arsye, MONUNI ka qenë ndër operatorët më të evidentueshëm dhe objektivist të përshtatshëm për t'u përfshirë në hulumtimin e tregut dhe për t'u ftuar në procedurë. Nga të dhënat publike të identikuara, profili i Offishop Group SH.P.K. lidhet kryesisht me furnizime të materialeve zyrtare, shkollore dhe mallrave të tjera. Ankuesi nuk pretendon pa konfirmim zyrtar se operatorët e ftuar nuk kanë poseduar licencë; pretendimi është se AK nuk ka paraqitur kriteret dhe dëshmitë mbi bazën e të cilave i ka konsideruar ata operatorë të përshtatshëm, ndërsa ka anashkaluar një operator të njohur, të licencuar dhe të kontraktuar më parë nga vetë AK-ja për të njëjtat shërbime. Kjo pabarazi objektive krijon dyshim të bazuar se përzgjedhja e operatorëve nuk është kryer mbi kriteret e njëjta, profesionale dhe të verifikueshme. Vetëm fakti se janë ftuar katër operatorë nuk provon konkurrencë të drejtë, nëse përzgjedhja fillestare është bërë pa metodologji të dokumentuar dhe pa përfshirë një operator të dëshmuar si MONUNI SH.P.K.

V. Mungesa e plotë e verifikimit të licencës dhe kapacitetit profesional e teknik

Në Fletën e të Dhënave të Tenderit, kërkesa e vetme e përshtatshmërisë profesionale ishte regjistrimi si operator ekonomik, ndërsa dëshmia e vetme ishte certifikata e regjistrimit të biznesit. Nuk është kërkuar leja DDD, përvoja në kontrata të ngjashme, personel i trajnuar, aplikues të biocideve, pajisje ULV, automjete, kapacitet operativ ose dëshmi për disponimin me preparate të autorizuara.

Kjo mungesë nuk është formale. Kontrata përfshinte trajtimin e 3,900 hektarëve me

teknologji ULV dhe preparate që përmbajnë cypermethrin, Piperonyl Butoxide dhe piriproksifen në zona urbane, rurale, parqe, zona të gjelbra dhe brigje lumenjsh. Pra, bëhet fjalë për aplikim kimik në shkallë të gjerë në hapësira publike.

Nga dokumentet e rezultatit rezulton se **Offishop Group SH.P.K. është konsideruar tenderues i përgjegjshëm** dhe është shpallur i pasuksesshëm vetëm sepse nuk kishte çmimin më të ulët. Ndërkohë, nga dokumentet publike të identifikuara, veprimtaria e regjistruar dhe profili i kësaj kompanie lidhen kryesisht me furnizime të materialeve zyrtare, shkollore dhe mallrave të tjera, ndërsa nuk rezulton aktiviteti i dokumentuar në fushën DDD. B52 konfirmon se tre nga katër tenderët e pranuar janë vlerësuar si të përgjegjshëm.

Rrjedhimisht, sipas kriterëve të publikuara, një operator pa aktivitet DDD të dokumentuar në regjistrimin e biznesit, pa staf profesional, pa pajisje ULV dhe pa përvojë të verifikuar mund të konsiderohej e përgjegjshme dhe, po të kishte ofruar çmimin më të ulët, mund të shpërblehej me kontratë. AK nuk mund ta eliminonte për mungesë licence, stafi ose pajisjesh mbi bazën e kriterëve që nuk i kishte vendosur në dosje.

Kjo bie drejtpërdrejt ndesh me obligimin e nenit 48.4 që, edhe në emergjencë, AK të luajë rol aktiv në përcaktimin e kushteve, sasive dhe karakteristikave teknike dhe të vlerësojë me kujdes cilësinë e shërbimit. Emergjencia e pretenduar nuk e zvogëlon nevojën për verifikim të sigurtisë dhe kapacitetit; përkundrazi, e bën atë edhe më të rëndësishëm.

VI. Kundërthënia me qëndrimin zyrtar të AK-së në procedurën e hapur

Vetëm disa javë para procedurës së negociuar, në procedurën e hapur nr. 651-26-4567-2-1-1, AK kishte kërkuar leje DDD të MBPZHR-së, epidemiolog me licencë pune, Bachelor të Mjekësisë Sanitare, aplikues të certifikuar të biocideve, pesë teknikë IPM, personel tjetër profesional dhe një numër të madh pajisjesh ULV e automjetesh.

Në vendimin e datës 30.06.2026, me të cilin kishte refuzuar kërkesën e MONUNI-t në procedurën e hapur, AK kishte arsyetuar se DDD janë masa të shëndetit publik; se biocidet dhe produktet kimike, nëse nuk aplikohen nga personel i trajnuar, mund të paraqesin rrezik për njerëzit, kafshët dhe mjedisin; dhe se licenca paraqet vetëm minimumin ligjor, ndërsa volumi i kontratës kërkon staf dhe pajisje shtesë.

Në procedurën e negociuar, për komponentin e njëjtë prej 3,900 hektarësh, AK ka kaluar nga një standard shumë i lartë – të cilin e kishte deklaruar “të domosdoshëm” për shëndetin publik – në mungesë të plotë të kërkesës për leje, staf, pajisje dhe përvojë. Ky ndryshim ekstrem nuk është arsyetuar dhe përbën kundërthënie të qartë në veprimin administrativ të të njëjtit autoritet.

Ankuesi nuk pretendon se të gjitha kriteret e rënduara të procedurës së hapur duhej të kopjoheshin në procedurën e negociuar. Pretendimi është se nuk mund të jetë njëkohësisht e ligjshme që AK të deklarojë stafin dhe pajisjet si domosdoshmëri për shëndetin publik, dhe pak javë më vonë të mos kërkojë as licencën bazike dhe asnjë kapacitet minimal për të njëjtin dezinfektim hapësinor.

VII. Publikimi i vonuar i B52 dhe ekzekutimi pa trajtimin e mjetit juridik

B52 deklaroi se kontrata është nënshkruar më 29.07.2026, ndërsa vetë B52 është përgatitur

më 04.08.2026 dhe është publikuar më 05.08.2026. Neni 21.8 (a) dhe neni 45.35.3 i

Rregullores kërkojnë përgatitjen e B52 brenda dy ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Përgatitja

më 04.08.2026 është jashtë këtij afati. Ankuesi nuk e mbështet pretendimin vetëm në faktin se

B08 u bë publikisht i qasshëm më 30.07, ndërsa kontrata figuron e nënshkruar më 29.07,

sepse platforma dallon datën e paraqitjes nga data e publikimit. Shkelja e dokumentuar është

vonësia e B52-së dhe, veçanërisht, fakti se AK nuk ka trajtuar fare kërkesën e datës 30.07.2026.

Sipas njoftimeve të vetë Drejtorisë së Shëndetësisë, dezinfektimi ka filluar më 01.08.2026.

Kështu, shërbimi është ekzekutuar ndërkohë që kërkesa për rishqyrtim mbeti pa vendim dhe pa

njoftim për zgjatje. Edhe nëse AK konsideron se procedura e emergjencës e ka lejuar

nënshkrimin dhe zbatimin e menjëhershëm, kjo nuk e ka liruar nga detyrimi për vendim të

arsyetuar dhe për publikimin e rregullt të B52-së.

VIII. Përfundim mbi bazueshmërinë e ankesës

Nga tërësia e fakteve rezulton se AK nuk ka provuar kushtet kumulative të emergjencës ekstreme; ka përzgjedhur operatorët pa kritere objektive të publikuara; nuk ka kërkuar as licencën dhe as kapacitetin minimal profesional e teknik; ka krijuar mundësinë që një operator pa kapacitete të verifikuara të shpërblehej vetëm mbi bazën e çmimit; ka vepruar në kundërtënie me qëndrimin e vet zyrtar në procedurën e hapur; ka përgatitur dosje me mospërputhje materiale; ka publikuar B52 jashtë afatit; dhe nuk ka nxjerrë asnjë vendim mbi kërkesën për rishqyrtim.

Realizimi i mundshëm i një pjese ose i tërë shërbimit nuk mund ta bëjë kontestin pa objekt dhe nuk duhet të përdoret si arsye për shmangien e shqyrtimit në themel. Përndryshe, një autoritet kontraktues do të mund ta bënte të paefektshëm mjetin juridik vetëm duke e ekzekutuar kontratën para se organi shqyrtues të vendoste.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mosftimi i MONUNI SH.P.K. i ka shkaktuar dhe kërcënohet t'i shkaktojë dëm material, sepse ankuesi është privuar nga mundësia reale për të paraqitur ofertë konkurruese dhe për të fituar një kontratë me vlerë 75,000.00 euro. Dëmi përfshin fitimin e humbur potencial, shpenzimet administrative, profesionale dhe juridike për mbrojtjen e të drejtave, dëmtimin e pozitës konkurruese dhe humbjen e mundësisë për krijimin e referencës së re kontraktuale.

MONUNI SH.P.K. rezervon të drejtën që, pas përfundimit të procedurës administrative dhe në bazë të konstatimeve të OSHP-së, të kërkojë pranë gjykatës kompetente kompensimin e plotë të dëmit material dhe çdo mjet tjetër juridik të lejuar me legjislacionin në fuqi.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*